

Ligjërata nga lënda:

Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacia Moderne

Përmbledhje ligjërata (II)

- Realizmi i shpjegon marrëdhëniet ndërkombëtare nga pikëpamja e fuqisë.
- Realistët e idealistët ndryshojnë në hipotezat e tyre për natyrën njerëzore, rendin ndërkombëtar dhe mundësitë për paqe.
- Fuqia mund të përfytyrohet si ndikim ose si aftësi që mund të krijojnë ndikim;
- Treguesi i vetëm më i rëndësishëm i fuqisë së një shteti është GDP-ja e tij.
- Aftësitë afatshkurtëra të fuqisë varen nga burimet afatgjata, si ato të prekshme dhe ato të paprekshme.
- Realistët e vështrojnë forcën ushtarake si aftësinë më të rëndësishme të fuqisë.
- Çështjet ndërkombëtare mund të shihen si një varg ndërveprimesh nëpërmjet marrëdhënieve në të cilat shtetet përdorin aftësitë e fuqisë si mjete për të ndikuar mbi përfundimet që do të arrihen.
- Përfundimet e procesit të marrëdhënieve varen jo vetëm nga fuqia si fuqi, por edhe nga strategjitë dhe rastësia.
- Ndërsjelltësia mund të jetë strategji vepruese për të arritur bashkëpunimin në marrëdhëniet ekzistuese, por bartë rrezikun e të shndërruarit në armiqësi të pakontrolluar ose gara armatimesh.
- Metodatat e aktorit të arsyeshëm i trajtojnë shtetet sikur të ishin individ që veprojnë për të plotësuar sa më shumë interes e veta. Këto thjeshtëzime janë të diskutueshme, por i lejojnë realistët që të përpunojnë modele e shpjegime të përgjithshme dhe të përmbledhura.
- Teoria e lojës nxjerr ide prej modeleve të thjeshtëzuara të rrethanave të caktuara marrëdhëniesh. Në dilemën e të burgosurit, pjesëmarrësit egoist nuk mund të arrijnë një bashkëpunim me përfitime të ndërsjella (përveçse me kalimin e kohës në rrethana të caktuara).
- Anarkia ndërkombëtare-mungesa e qeverisë së botës-nënkupton se çdo shtet është një aktor Sovran e autonom që ndjek interes e vet kombëtar.
- Sistemi ndërkombëtar thekson tradicionalisht sovranitetin e shteteve, të drejtën e tyre për të kontrolluar problemet brenda territorit të vet dhe përgjegjësinë për të respektuar kufijtë e njohur ndërkombëtarisht.
- Shtatë fuqi të mëdha llogaritet të zotërojnë gjysmën e GDP-së botërore, si edhe pjesën më të madhe të forcave ushtarake dhe të aftësive të tjera të fuqisë.
- Teoria e kalimit të fuqisë thotë se luftërat shpesh rrjedhin prej ndryshimeve në shpërndarjen relative të fuqisë në sistemin ndërkombëtar.
- Hegjemonia-mbizotërimi i një shteti në sistemin ndërkombëtar-mund të ndihmojë për të ofruar paqe e qëndrueshmëri në marrëdhëniet ndërkombëtare, por me disa problem.

- Shtetet formojnë aleanca për të rritur fuqinë e tyre vepruese në krahasim me një shtet ose aleancë tjetër.
- Aleancat mund të ndryshojnë me shpejtësi, duke sjellë rrjedhoja të mëdha në marrëdhëniet midis fuqive.
- Aleancat kryesore të botës, përfshirë NATO-n dhe aleancën SHBA-Japoni, përballen me role të paqarta në një rend botëror në ndryshim.